

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KUÇOVE

VENDIM

NR. 48 DATE 09.12.2015

MBI MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TE VITIT 2016

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 09/ 12/ 2015, analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e te Ardhurave mbi miratimin e paketes fiskale te vitit 2016, mbeshtetur ne ligjin nr.8652, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 7 pika 2 , te ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ”Per sistemin e taksave vendore” me ndryshimet perkatese si dhe Udhezimit Nr 655/1 date 06.02.2007, dhe te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne R.SH. :

VENDOSI:

Të miratoje nivelin e taksave dhe tarifave për vitin 2016, si më poshtë:

1. TAKSA VENDORE BIZNESIT TE VOGEL

A Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel

Te ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel per vitin 2016 do te realizohen ne zbatim te ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ”Per sistemin e taksave vendore” te ndryshuar me ligjin

Nr _____, date _____ 2015.

I Shkalla tatimore

1. Niveli i tatimit per subjektet e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 deri ne 5 milion leke, eshte 0 (zero) leke ne vit.
2. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshem, per subjektet e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel, me qarkullim nga 5 deri ne 8 milion leke, eshte 5 per qind mbi fitimin e tatueshem

II Parapagimi

1. Te gjithë tatimpaguesit me qarkullim nga 5 deri në 8 milion leke paguajne tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël të ndarë në katër keste.
 - Brenda datës 20 prill kryhet pagesa e kestit të I -re
 - Brenda datës 20 korrik kryhet pagesa e kestit të II -te
 - Brenda datës 20 tetor kryhet pagesa e kestit të III -te
 - Brenda datës 20 dhjetor kryhet pagesa e kestit të IV –te
2. Pagesa e tatimit të thjeshtuar të fitimit për biznesin e vogël kryhet në bankat e nivelit të dytë për llogari të administratës tatimore qendrore.

- Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Periudha e detyrimit vjetor fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të vitit në vazhdim.
- Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet për çdo biznes, qoftë ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, me anë të të cilit realizohet një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) 5 deri 8,000,000 leke.
- Taksa vendore mbi biznesin e vogël paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytesore) ku subjekti zhvillon aktivitet.
- Nëse subjekti taksapagues rregjistrohet rishtaz, pezullon veprimtarinë ose aplikon për regjistrim pranë Q.K.R-se gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumezuar nivelin e takses për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose regjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Kur afati i fundit i pagesës së kestit bie ditë pushimi apo ditë feste, atëherë si ditë të fundit të pagesës së kestit do të merret dita e parë e punës pas ditës së pushimit

III Administrimi i tatimit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arketimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

IV Transferimi i të ardhurave

1. Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël të llogaritë të Bashkisë brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arketuar tatimet.
2. Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen mer një komision në masën 1 % të shumës së tatimit që kanë arketuar.

IV Bashkepunimi

1. Per realizimin e te ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel, Bashkia bashkepunon me Drejtorine Tatimore Rajonale, ne zbatim te ligjit nr.181/2013 date 28.12.2013.

2. TAKSA E PASURIVE TE PALUAJTSHME PER NDERTESAT

Ne zbatim te ligjit nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" te ndryshuar me ligjin nr. 181/2013 date 28.12.2013 neni 5, niveli i taksës per vitin 2016 per kater Njesite Administrative te Bashkise Kucovedo te jete :

Lloji Takses/Tarifës	Njesia matese	KUCOVA	KOZARE	PERONDI	LUMAS
Taksa e Nderteses					
I. Ndertesa banimi					
a. banesa para vitit '93	Leke/m2/vit	5	3	3	3
b. banesa gjate dhe pas' 93	Leke/m2/vit	6	6	6	6
II. Ndertesa te tjera					
a. Ndertesa te subjekteve te biznesit te madh dhe te vogel	Leke/m2/vit	200	100	100	100
III. Te tjera					
a. Objekte te ish ndermarrjeve shteterore te privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitetet biznesi dhe sheshe parkimi, perpunimi e lodrash per femije dhe objekte te tjera qe nuk perfshihen ne kategorite e mesiperme	Leke/m2/vit	40	20	20	20

Per tatimpaguesit qe kane ne pronesi me shume se nje banese;

- Per shtepine ku banon paguajne sipas pikes 2 te tabelës se meposhteme
 - Per te gjitha shtepite e tjera, taksa e nderteses eshte sa dyfishi i taksës se nderteses, qe zbatohet ne zonen ku ndodhet kjo ndertese.
- Baza e taksës mbi ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit ne meter katror e nderteses ose e pjesës se saj, mbi dhe nen nivelin e tokës dhe per çdo kat.

Siperfaqja ne pronesi te taksapaguesit percaktohet sipas dokumenteve qe e vertetojne kete pronesi.

- Taksa mbi ndertesat per kategorine I “Ndertesa Banimi” (nga familjet) paguhet per cdo ndertese qe qytetari ka ne pronesi.
- Taksa mbi ndertesat per kategorine II “Ndertesa te tjera” dhe kategorine III “Te tjera”, paguhet per cdo adrese (kryesore dhe dytesore) ku subjekti zhvillon aktivitet.
- Agjent tatimor per vjeljen e taksës mbi ndertesën per kategorine I “Ndertesa Banimi” (nga familjet), eshte “Sh.A Ujesjelles Kanalizime”.
- Struktura e ngarkuar per vjeljen e taksës mbi ndertesën per kategorine II “Ndertesa te tjera” dhe kategorine III “Te tjera”, eshte Drejtoria e te Ardhurave .
- Per biznesin e vogel , likuidimi i kesaj takse behet brenda dates 31 Mars 2016 dhe per Biznesin e madh dhe Nderm/Institucionet afati i pageses eshte periudha Janar-Qershor 2016.
- Struktura e ngarkuar per mbledhjen e saj eshte Drejtoria e te Ardhurave ne Bashki. Per subjektet e reja , pagesa behet ne momentin e regjistrimit.
- Per Familjaret,afati i pageses eshte Janar-Mars. Agjent tatimor do te jete Ndermarrja e Ujesjelles Kanalizimeve sh.a. e cila do te perfitoje 2.5 % te te ardhurave te grumbulluara nga kjoTakse, mbi bazen e akt-rakordimeve midis paleve.

Perjashtimet

1. Nga pagesa e Taksës mbi Ndertesën, perjashtohen :

a.Te verberit

b.Veteranet e LANÇ – it

c.Invalidet

2. Perjashtimet behen kur veprimet behen ne emer te kategorise qe perfiton pra, **kur personi qe perfiton eshte kryefamiljar.**

Kjo zbatohet kur asnje person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.

3. Drejtoria e te Ardhurave te Bashkise kerkon brenda muajit Janar nga Shoqatat respektive Listen zyrtare te personave qe perfitojne nga keto perjashtime.

3. TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

Per vitin 2016 mbi bazen e te dhenave per pronaret e tokave bujqesore do te vilet edhe kjo takse. Niveli i kesaj Takse jepet ne Nenin 23 te ligjit 9632 date 30.10.2006.

Taksa e Tokes Bujqesore	Njesia matese	KUCOVA	KOZARE	PERONDI	LUMAS
Kategoria e I	Leke/ha/vit	4620	4200	4200	4200
Kategoria e II	Leke/ha/vit	3850	3500	3500	3500
Kategoria e III	Leke/ha/vit	3080	2800	2800	2800
Kategoria e IV	Leke/ha/vit	2530	2300	2300	2300
Kategoria e V	Leke/ha/vit	2090	1900	1900	1900

Kategoria e VI	Leke/ha/vit	1760	1600	1600	1600
Kategoria e VII-X	Leke/ha/vit	1540	1400	1400	1400

se Klasifikimi sipas kategorive te tokes bujqesore eshte bere nga strukturat e Ministrise

Bujqesise dhe Ushqimit.

- Baza e takses mbi token bujqesore eshte siperfaqja e tokes bujqesore, ne hektar, ne pronesi te taksapaguesit. Siperfaqja ne pronesi te taksapaguesit percaktohet sipas dokumenteve qe e vertetojne kete pronesi.
- Detyrimi per taksen mbi token bujqesore eshte vjetor. Ky detyrim paguhet me nje kest te vetem.
- Agjent tatimor per vjeljen e takses mbi token bujqesore nga familjet jane njesite administrative

4. TAKSA E TRUALLIT

- Taksa e truallit do te aplikohet per here te pare sipas ligjit nr. , date 2015.
-

5.TAKSA E KALIMIT TE SE DREJTES SE PRONESISE MBI NDERTESAT

Nr	Kategoria e Nderteses	Leke/m2
1	Per ndertesa banimi	100
2	Per ndertesa per tregti e sherbime	300
3	Per ndertesa te tjera	200

- Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset per ndertesat dhe te gjitha pasurite e paluajtshme ne castin e kalimit te se drejtes se pronesise mbi to.
- Baza e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme eshte siperfaqja e ndertimit, pronesia e se ciles transferohet.
- Baza e takses per kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e tjera te paluajtshme eshte vlere e shitjes se tyre. Niveli i takses caktohet ne perqindje dhe niveli tregues i takses eshte **2 %** .
- Agjent tatimor per vjeljen e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme eshte Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme e cila perfiton 3% te shumes se arketuar.

Afatet e pageses

- Taksa paguhet nga personi, qe kalon te drejten e pronesise mbi pasurine e paluajtshme, para kryerjes se regjistrimit, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi.
- Te ardhurat nga taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme derdhen per llogari te buxhetit te Bashkise ne territorin e se ciles ndodhet pasuria, jo me vone se data 30 e muajit pasardhes.

6. TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Ne zbatim te ligjit nr , date 2015, baza e taksës së fjetjes në hotel, është regjistrimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë. Janë subjekt i Taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie. Niveli i taksës është 140 leke/fjetje.

	Baza e taksës	Niveli
1	Regjistrimi i fjetjes per dhome ose person	140 leke/fjetje/nate

Struktura e caktuar per vjeljen e kesaj takse eshte Drejtoria e te Ardhurave.

7. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE

Taksa e ndikimit ne infrastrukture	Njesia matese	KUCOVA	KOZARE	PERONDI	LUMAS
a.Per projekte te Infrastruk.	% e vleres invest	0.1	0.1	0.1	0.1
b.Ndertime te tjera(biznes)	% e vleres invest	3	3	3	3
c.Shtepi banimi	% e vleres invest	2	2	2	2
d.Per Ndert.ne proces legal.	% e vleres invest	0.5	0.5	0.5	0.5
e.Per Leje Rikonstruksioni (Deklarate paraprake punimesh	% e vleres invest	1	1	1	1

- Baza e taksës së ndikimit mbi infrastrukture nga ndertimet e reja është vlera në leke e investimit të ri që kërkohej të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhenien e lejes së ndertimit.
- Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit
- Detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukture i takon investitorit
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukture për kategorinë I “Per ndertesa banimi”, kategorinë II “Per ndertesa te tjera (biznes, tregti, sherbim, prodhim etj)” dhe kategorinë III “Per projektet e infrastruktures, per ndertimin e rrugëve kombetare, te porteve, aeroporteteve, tuneleve, digave, ndertimit te infrastruktures ne energji, perfshire makinerite dhe pajisjet per keto projekte.” është Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, ndërsa për kategorinë IV “Per ndertesat qe jane ne proces legalizimi”, agjent tatimor për vjeljen e kesaj takse është A.L.U.I.Z.N.I Berat.

Afatet e pagesës

- Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukture do të bëhet para marrjes së lejes së ndertimit menjëherë pas miratimit nga KRRT-ja e Bashkisë. Në rast se subjekti nuk ben

pagesen brenda nje muaji nga data e zbardhjes se lejes se ndertimit ateher shfuqizohet leja e ndertimit per kete objekt.

Struktura e caktuar per vjeljen e kesaj takse eshte Drejtoria e Urbanistikes.

8. TAKSAT NGA LEGALIZIMIET

Taksa nga Leja e Legalizimit dhe Taksa e Sherbimit (sipas VKB – se per Taksat e Ndikimit ne Infrastruktura.)

Tarifa e Sherbimit per legalizim do te jete 4 000 leke per cdo objekt qe legalizohet.

Ne rast se objekti per te cilin do te kryhet investimi do te shtrihet ne territorin e me shume se njesie vendore ose kur **objekti** ndikon ne infrastrukturen e nje njesie tjeter vendore, te ardhurat nga Taksa ndahen proporcionalisht midis tyre, ne raportet perkatese te shtrirjes se objektit dhe te ndikimit te investimit ne infrastrukturen e seciles njesi.

9. TAKSA PER ZENIEN E HAPESIRAVE PUBLIKE

Takse per zenie te Hapesires Publike	Njesia matese	Leke /m2/ muaj			
		KUCOVA	KOZARE	PERONDI	LUMAS
Hapesira Publike Organizimi i spektakleve ose panairove te ndryshme	Leke/m2/muaj	60	30	30	30

- Baza e takses per zenie te hapsirave publike eshte siperfaqja ne m², e cila vihet ne shfrytezim nga individe dhe subjekte te ndryshem.
- Taksa per zenie te hapsirave publike llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.
- Detyrimi i takses perlllogaritet si shumezim i bazes (siperfaqes) me nivelet treguese te saj.
- Per rastin e perdorimit te siperfaqes publike me qellim organizimin e spektakleve ose panairove te ndryshme fillimisht subjekti duhet te paraqese prane Bashkise, kerkesen per shfrytezim te hapsires publike.
- Subjekti do te lidhe kontrate me Bashkine per zenien e hapesires publike per dymbedhete muajt e vitit.
- Struktura e ngarkuar per vjeljen e takses per zenien e hapsirave publike eshte Drejtoria e te Ardhurave.

- Ndalohet zenia e hapsirave publike (trotuare, sheshe etj), te cilat nuk jane te miratuara nga Bashkia

Afatet e pageses

- Per kategorine II “Organizim i spektakleve ose panairove te ndryshme”, pagesa kryhet menjehere me marjen e lejes perkatese nga Bashkia .
- Per kategorine I “Zenie hapsire publike per qellime tregtimi ne tregjet publike” , pagesa do te behet brenda dates 20 Prill.

Subjekti paraqet kerkesen dhe merr lejen prane Drejtorise se Urbanistikes per siperfaqen dhe periudhen e kerkuar (12 muaj), e mbi bazen e kesaj leje lidh kontraten me Drejtorine e te Ardhurave.

Pagesa behet totale dhe e menjehershme ne momentin e lidhjes se kontrates.

Struktura e caktuar per vjeljen e kesaj takse eshte Drejtoria e te Ardhurave.

10. TAKSA E TABELES

TAKSA E TABELES					
I. TABELE PER QELLIME IDENTIFIKIMI:	Njesia matese	KUCOVA	KOZARE	PERONDI	LUMAS
a. Tabele per qellime identifikimi, pavaresisht nga sip. te trupezuara ne sip. e nderteses ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi.	Leke/vit	132	120	120	120
b. Tabele per qellime identifikimi jashte territorit ku zhvillohet aktiviteti.	Leke/vit	132	120	120	120
1. BIZNESI					
- Biznesi i Vogel	Leke/vit	132	120	120	120
- Biznesi i Madh	Leke/vit	132	120	120	120
2.ND/INSTITUC.	Leke/vit	132	120	120	120
II. TABELE PER QELLIME REKLAMIMI, TE THJESHTA & ELEKTRONIKE:	Leke/m2/vit	13500	13500	13500	13500

III. TABELE NE FUNKSION TE EKSPOZIMEVE TE NDRYSHME TE HAPURA, PANAIRE, SPEKTAKLE, ETJ.	Leke/m2/dit	1000	1000	1000	1000
--	-------------	------	------	------	------

a) Taksa per qellime identifikimi paguhet nga cdo subjekt qe ushtron aktivitet, pervec ambulanteve dhe subjekteve te transportit.
Struktura e caktuar per vjeljen e kesaj takse eshte Drejtoria e te Ardhurave, Bashkia Kucove.

b) Per tabelat reklamuese, ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës qe te leshoje lejet per vendosjen e tabelave reklamuese ku specifikohet vendndodhja dhe siperfaqja e caktuar dhe informon me shkrim per çdo leje te dhene Drejtorine e te Ardhurave.

Detyrimi për Taksën e Tabelës është vjetor.

Per biznesin e vogel taksa paguhet brenda datës 31 Mars të vitit fiskal dhe per subjektet e regjistruar

rishtazi, ne momentin e regjistrimit.

Per biznesin e madh dhe ndermarrjet/Institucionet afati i pageses eshte deri ne muajin Qershor.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e te Ardhurave .

11. TAKSA E RREGJISTRIMIT TE PERVITSHEM TE MJETEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR

Kjo Takse eshte e percaktuar me ligjin 9632 date 30.10.2006 neni 30, ku sipas ligjit kategorite taksapaguese dhe niveli i taksës per cdo kategori mjetesesh te transportit rrugor mbetet sipas ligjit.

Agjenti tatimor

Agjent tatimor eshte Drejtoria Rajonale e Sherbimit te Transportit Rrugor Berat dhe te ardhurat ndahen:

- | | | |
|----|--------------------------------|------|
| a. | DPSHTRR | 5 % |
| b. | Drejtoria e Qarkullimit Rrugor | 1 % |
| c. | Bashkia Kucove | 94 % |

Afati i pageses

Afati per shlyerjen e ketij detyrimi eshte momenti i kryerjes se kontrollit teknik vjetor brenda vitit. Te ardhurat derdhen per llogari te Bashkise nga DSHTRR – ja Berat brenda dates 10 te cdo muaji.

Menyra e pageses

Taksa paguhet e plote edhe per mjetet qe rregjistrohen per here te pare pavaresisht nga data e rregjistrimit dhe eshte e vlefeshme per 365 dite.

Perjashtimet

Ne nenin 31 te Ligjit 9632 date 30.10.2006 jepen edhe perjashtimet nga pagimi i kesaj Takse qe jane mjetet ne pronesi te Trupave Diplomatike dhe te Organizatave nderkombetare te akredituara ne R.SH.

TARIFAT VENDORE

Tarifa e Pastrimit	Njesia	KUCOVA	KOZARE	PERONDI	LUMAS
<i>I. Per Familjet</i>	matese				
a. Familjet me ndihme soc.					
Invalid,verb er,vet.LAN C dhe pensioniste te vetmuar	Leke/vit	400	400	400	100
b. Familjet e tjera	Leke/vit	1500	800	500	300
<i>II. Per biznesin e Vogel</i>				2500	5000
<i>Tregti dhe sherbime</i>			5000	5000	5000
a.Ushqimore ,bulmetore	Leke/vit	18000			
b. Fruta perime	Leke/vit	12000			
c.Mish. peshk	Leke/vit	21000			
d.Art. Industrilale	Leke/vit	10000			
e.Bare,kafen e	Leke/vit	21000			
f.Restorante	Leke/vit	24000			
g.Sherbime, artizanat	Leke/vit	12000			
iFast food	Leke/vit	12000			
j.Prodhimi	Leke/vit	25000			
k.Pasticeri	Leke/vit	15000			

III. Per biznesin e Madh					
<i>a. Ushqimore</i>	Leke/vit	24000	20000	20000	20000
<i>b. Art. Te ndryshem</i>	Leke/vit	20000	20000	20000	20000
<i>c. Sherbime</i>	Leke/vit	17000	20000	20000	20000
<i>d. Ndertim</i>	Leke/vit	60000	30000	30000	30000
<i>e. Prodhim</i>	Leke/vit	40000	30000	30000	30000
<i>f. Lloto sportive</i>	Leke/vit	22000	20000	20000	20000
<i>g. Loja Fati Elektronike</i>	Leke/vit	35000	20000	20000	20000
<i>gj. Kalceto</i>	Leke/vit	20000	20000	20000	20000
<i>h. Supermarket</i>	Leke/vit	50000	20000	20000	20000
<i>i. Fasionet</i>	Leke/vit	60000	20000	20000	20000
IV. Transporti					
<i>a. Mjete transp. Mall</i>	Leke/vit	2000	2000	2000	2000
<i>b. Mjete transp. TAXI Udhetar</i>	Leke/vit	5000	5000	5000	5000
Shoqata e transp. Udhetar					
<i>c. Shoqeria Dolese Sineci</i>	Leke/vit	30000			
<i>d. Shoqeria Kucova</i>	Leke/vit	30000			
<i>e. Shoqeri te tjera</i>	Leke/vit	10000			
V. Ndermarrjet/Instituci.					
<i>1. AlbPetrol sha</i>	Leke/vit	1000000			
<i>2. Filiali Elektrik CEZ</i>	Leke/vit	90000			
<i>3. Ujesjellesi</i>	Leke/vit	100000			

4.Bankat	Leke/vit	90000			
5.Albteleko mi	Leke/vit	180000			
6.Filiali Albapostes	Leke/vit	29000			
7.Zyra e Punes	Leke/vit	7000			
8.Zyra e Rregjistr. Pasurise	Leke/vit	15000			
9.Dega e Thesarit	Leke/vit	7000			
10.Drejto. Shendetit Publik	Leke/vit	33000			
11.Drejto. e kujdesi paresor	Leke/vit	55000			
12.Drejto. e sherbim. spital	Leke/vit	33000			
13.Sigurime t Shoqerore	Leke/vit	10000			
14.Drejto e Sherbimit Pyjor	Leke/vit	5000			
15.Komisari ati Policise	Leke/vit	5000			
16.Departa menti Bujqesise	Leke/vit	10000			
17. <i>Departa menti Arsimit</i>	Leke/vit	55000			
18.Dega e Tatim- Taksave	Leke/vit	10000			
19.Sherbimi Funeral	Leke/vit	16500			
20.Sherbimi Dekorit	Leke/vit	5000			
21.Sherbi.Pa strimi”Higje n”	Leke/vit	40000			
22.Deget Kompan	Leke/vit	30000			

Siguri.					
23.Enti Soc.Kult.i Ushtrise	Leke/vit	25000			
25.Kadastra	Leke/vit	5000			
26.Instati	Leke/vit	5000			
27.Shkolla Private	Leke/vit	25000			
28.Western, Besa etj.	Leke/vit	25000			
29.Nenprefektura	Leke/vit	5000			
30.Bankers Petroleum	Leke/vit	1000000			
31.Kinema	Leke/vit	10000			

Tarifa e Ndricimit Rrugor		Njesia matese	KUCOVA	KOZARE	PERONDI	LUMAS
<i>I.Familjet</i>						
a. Familje ndihme ekonomike,invalid.,veteran, pensionist vetmuar	Leke/vit	400	400	400		
b.Familjet e tjera	Leke/vit	1200	600	600		
<i>II. BIZNESI</i>						
a. Biznesi i madh	Leke/vit	6000	3000	3000		
b. Biznesi I vogel	Leke/vit	3000	2000	2000		
<i>III. Nd-jet dhe Institucion</i>						
<i>Ndermarrjet</i>						
<i>Albpetrol</i>		20000				
<i>Tec</i>		15000				
<i>Filiali Elektrik</i>		15000				
Ndermarrja e Ujesjellesit		15000				

Tarife per Sherbimin e Gjelberimit dhe Mjedisit		Njesia matese	KUCOVA	KOZARE	PERONDI	LUMAS
<i>I. Familjet</i>						
a.Fam.ndihme.ekon,Veteran, invalid,pensioniste te vetmuar	Leke/vit	200				
b. Familjet e tjera	Leke/vit	600				

II. Biznesi					
a. Biznesi i madh	Leke/vit	5000			
b. Biznesi i vogel	Leke/vit	2000			
III. Institucionet		10000			
IV. Ndermarrjet					
a. AlbPetrol sha	Leke/vit	500000			
b. Filiali Elektrik	Leke/vit	20000			
c. Ujesjellesi	Leke/vit	20000			
d. TEC	Leke/vit	20000			
f. Bankers Petroleum	Leke/vit				

Kur detyrimi per keto tarifa lind 6/mujorin e dytë të vitit, ato paguajnë 50 % të detyrimit.

Struktura e ngarkuar per mbledhjen e ketyre tarifave eshte Drejtoria e Te ardhurave

Agjentet Tatimore

- Per abonentet familjare te njesise administrative Kucove, keto Tarifa do te grumbullohen nga Ujesjellesi Kucove e cila ne rolin e Agjentit Tatimor do te perfitoje : 2.5 % te shumes se arketuar.
- Agjenti Tatimor percaktohet ne Vendim te Keshillit Bashkiak..
- Per biznesin privat, Ndermarrjet dhe Institucionet ngarkohet Drejtoria e te Ardhurave te Bashkise.

Tarifat e Pastrimit, do te paguhet :

- Nga biznesi i vogel **deri 30 qershor 2016**
- Nga biznesi i madh **deri Qershor 2016**
- Nga Ndermarrjet e Institucionet **deri Qershor 2016**
- Nga abonentet Familjare **çdo muaj ne faturen e Ujesjellesit**

Tarifat e Gjelberimit dhe Ndricimit do te paguhet :

- Nga biznesi i vogel **deri ne 30 shtator 2016**
- Nga biznesi i madh **deri Qershor 2016**
- Nga Ndermarrjet e Institucionet **deri Qershor 2016**

Shkembimi i Informacionit

1. Çdo fund muaji do te dergohet informacion prane Drejtorise se te Ardhurave te Bashkise nga arketimet e kesaj Tarife nga Abonentet Familjare.
2. Te gjitha shoqatat e Invalideve, Te verberve, Veteraneve dhe Ndhima ekonomike prane Bashkise brenda muajit Janar 2016, te vene zyrtarisht ne dispozicion te Drejtorise se te Ardhurave te Bashkise listat perkatese.

Perjashtimet

Mbeshtetur ne ligjin 7874,date 17.22.1994, ”Per Statusin e Veteranit te Luftes kunder pushtuesit nazifashist te popullit shqiptar”,i ndryshuar, Ligjit 7889,date 14.12.1994 “Per statusin e te verberit”,dhe Ligjit 7889,date 14.12.1994 “Per Statusin e Invalidid”, **Invalidet dhe veteranet e luftes, invalidet e punes, te verberit, invalidet paraplegjike dhe tetraplegjike qe e fitojne kete status**, perjashtohen nga taksat dhe tarifat e drejtperdrejta si me poshte:

- Taksa mbi ndertesat
- Taksa mbi token bujqesore
- Taksa e rregjistrimit te pervitshem te mjeteve
-

4.TARIFA E PARKIMIT

Tarifa e Parkimit	Njesia matese	BASHKIA
<i>I.Transporti Udhetar (per cdo mjet)</i>		
a. Per autobuzat e shoq Dolese	Leke/vit	7000
b.Per autobuzat e shoq. Kucova	Leke/vit	6500
c. Per autobuzat e shoq. te tjera	Leke/vit	6000
d.Per mikrobuzat taksi 8 +1	Leke/vit	6000
e. Per autoveturat taksi(4+1)	Leke/vit	3500
<i>II. Transporti Malli</i>		
<i>Per kamjonat (furgonat private per cdo mjet)</i>		
a.Per mjete deri 3.5 ton	Leke/vit	3000
b.Per mjete mbi 3.5 deri 8 ton	Leke/vit	4500
c.Per mjete 8 deri ne14ton	Leke/vit	5500
d.Per mjete mbi 14 ton	Leke/vit	7000
Tarife Park.auto familjare		
1. Tarife Vjetore	Leke/vit/automjet	1000
2. Tarife orare	Leke/ore	30
Parkim me pagese ne sheshe dhe rruget kryesore		
Tarifa e Parkimit te Rezervuar	Leke/vit/ 1 vend	5000

Struktura e ngarkuar per mbledhjen e **tarifave te parkimit** te autobuzeve dhe Mjeteve te transportit te mallrave eshte Drejtoria e Te ardhurave ne bashkepunim me Drejtorine e Sherbimeve dhe transportit .

Tarifa e **Parkimit te Autoveturave Familjare vjetore dhe orare**, te parkimit me pagese, do te arketohet, nga agjenti i perzgjedhur nga **Kryetari i Bashkise** .

Ne momentin e pageses çdo subjekt pajiset me faturen perkatese te pageses te cilen e ruan ate deri ne fund.

Tarifa e Parkimit Autofamiljar vjetore paguhet brenda muajit Qershor , duke i lindur e drejta per te mos paguar tarifen orare te parkimit .

Tarifa e Parkimit Autofamiljar orare do te paguhet ne momentin e parkimit, si dhe ne momentin e largimit kur koha e parkimit kalon mbi nje ore.

Drejtoria e Sherbimeve dhe Transportit ne Bashki autorizon bizneset per **parkim te rezervuar**, pasi keta te fundit kane bere pagesen e tarifes qe konfirmohet dhe nga Drejtoria e te Ardhurave.

Tarifes se Parkimit per mjetet e transportit do ti nenshtrohen te gjitha mjetet qe pajisen me Leje Transporti nga Drejtoria e Transportit te Bashkise.

5. TARIFA E LEJE TRANSPORTI

Tarifa e Leje transporti	Njesia matese	BASHKIA
Transport Udhetar		
a. Per autobuzat	Leke/5 vite	75000
b.Per mikrobuzat taksi 8 +1	Leke/5 vite	20000
c. Per autoveturat taksi(4+1)	Leke/5 vite	20000
Transport Malli		
a.Per nevojat e veta (here te pare)	Leke/vit	2000
b.Perseritje e lejes	Leke/vit	1600
c.Per te trete/ose me qira	Leke/vit	8000
Tarife per Tonazh	Leke/ton	100

Struktura e ngarkuar per mbledhjen e tarifave te leje transportit eshte Drejtoria e Sherbimeve dhe transportit ne bashkepunim me Drejtorine e Te ardhurave .

Drejtoria e Sherbimeve dhe transportitpajis çdo subjekt me faturen perkatese te pageses te cilen subjekti e mbyll ne Banke.

Tarifa per leje transporti paguhet para marjes se Lejes se Transportit.

6. TARIFAT E TREGUT

Tarifa e TREGUT			
	1.Tregu i pergendruar ne Kucove	Leke/muaj/tregtar	
	Fruta Perime shesh	Leke/muaj/tregtar	1 470
	Industriale shesh	Leke/muaj/tregtar	1 470
	Fruta perime banak tek	Leke/muaj/tregtar	2 100
	Industriale banak tek	Leke/muaj/tregtar	2 100
	Kafe bluar	Leke/muaj/tregtar	1 470
	Vendshitje mishi	Leke/muaj/tregtar	5 600
	Tregtim byreke	Leke/muaj/tregtar	3 500

	Bulmetore banak tek	Leke/muaj/tregtar	2 100
	2. Tregu i Lire ne Kucove dhe Lumas		
	- Tarifa ditore-		
	Tregtim fruta perime	Leke/tregtar/box	50
	Tregtim rroba te perdorura	Leke/tregtar/box	50
	Tregtim industriale te perdorura	Leke/tregtar/box	50
	Tregtim me makina jashte tregut:	Leke/tregtar/box	150
	Tregtim peshku	Leke/tregtar/box	200
	Vendosje tavoline	Leke/tavoline	50
	- Tarifa mujore -		
	Tregtim fruta perime	Lek/muaj/tregtar	1 500
	Tregtim rroba te perdorura	Lek/muaj/tregtar	1 500
	Tregtim industriale te perdorura	Lek/muaj/tregtar	1 500
	3. Tarife e lenies se mallit	Leke/muaj/tregtar	500

A. TREGU I PERQENDRUAR

Te gjithë tregëtarët e **Tregut të Perqendruar**, brenda muajit Janar, janë të detyruar të lidhin kontratën me Bashkinë e cilës ka afat 1 vjeçar (vit kalendarik).

a. Pagesa e Tarifës së Tregut bëhet brenda **dates 20 të cdo muaji** me pagesë të menjehershme për muajin pranë Agjencive Bankare në Kucovë.

b. Cdo tregëtar mund të zbriten nga pagesa **jo më shumë se 30 dite në vit** (raste semundje, fatkeqesi familjare, pushime)

Pagesa e tarifës së tregut nga tregëtarët e tregut të Lire do të bëhet të personi i ngarkuar nga Bashkia Kucovë (Drejtoria e të Ardhurave)

B. TREGU I LIRE

Ky treg zhvillohet pranë tregut të perqendruar në njesinë administrative Kucovë dhe në njesinë administrative Lumas dhe pagesa do të kryhet sipas së tabelës së mësipërme .

Pagesa e tarifës së tregut të lire nga tregëtarët do të bëhet të agjenti tatimor i Njesisë Administrative perkatese

7. TARIFA E LENIES SE MALLIT

Pagesa e **Tarifës së Lenies së Mallit në Tregun e Perqendruar** do të jete mujore dhe do të paguhet në Agjencite Bankare brenda dates 20 të cdo muaji.

Tarifës së Lenies së Mallit do të nënshtrohen të gjithë ata tregëtarë që lenë mallin në tregun e Perqendruar

Për tregëtarët që kanë nga 2 bokse të cilet komunikojnë me njëri tjetrin do të paguhet vetëm një vlerë e tarifës .

Në rastet kur dy bokset nuk komunikojnë me njëri tjetrin do të paguhet e ndare.

Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë brenda muajit Janar lidh kontratën me të gjithë tregëtarët që lenë mallin në tregun e lire. Te ardhurat e krijuara nga kjo Tarife i takojnë 100 % Bashkisë Kucovë.

8. TARIFAT E SHERBIMEVE

	Tarifa per sherbime te kryera nga Administrata e Bashkise	Njesia matese	Bashkia
I	TARIFAT E DREJTORIVE		
A	Drejtoria e Mjedisit		
	Sherbime dizinfektimi ne familje	Leke/m2	100
	Sherbime dizinfektimi ne institucione	Leke/m2	200
	Dhenie Mendimi per Leje Mjedisore	Leke	2 000
	Tarife therje per gjedh dhe derra	Leke/koke/therur	150
	Tarife therje per te imta	Leke/koke/therur	100
	Tarife per shfrytezimin e lendes drusore	Leke/m3	500
B	Drejtoria e te Ardhurave		
	Vertetime te ndryshme	Leke	50
	Vertetime per tender	Leke	500
	Akt-shbllokimi te firmave private	Leke	100
C	Drejtoria e Urbanistikes		
	Hartim plan-vendosje dhe planimetri per qytetaret	Leke	3 000
	Leje perdorimi te objektit	Leke	8 000
	Leje perdorimi	Leke	25 000
	Tarife sherbimi per legalizim	Leke	4 000
	Terheqje dokumenti nga arkiva	Leke	1 000
	Vertetim i thjeshte	Leke	100
	Vertetime te tjera	Leke	500
	Fotokopje Harte	Leke	5 000
	Fotokopje Stud.Urban, formulari A1	Leke	1 000
	Ekstrat PVD	Leke	15 000
	Dhenie leje perdorimi per biznes	Leke	15 000
	Dhenie leje perdorimi per baneese	Leke	10 000
	Dhenie mendimi / vendimi mjedisor	Leke	3. 000
D	Te tjera		
	Vertetim per banor rezident	Leke	100
	Vertetim per ndryshim emri/mbiemri	Leke	100
	Deshmi martesore	Leke	400
	Deshmi sjellje	Leke	100
II	Dhenie me qera		
	Salla e Keshillit Bashkiak , Salla e Qendres Rinore , Qender Kulturore “Feniks”		
	Per Vendas		
	Per 1 ore	Leke	2000
	Per 1 dite	Leke	10000
	Mbi 10 dite	Leke	8000
	Per te Huaj		
	Per 1 ore	Leke	4000
	Per 1 dite	Leke	20000

	Mbi 10 dite	Leke	15000
III	Tarife per Dhenie Leje NON-STOP		
	Per bare ,restorante ,disko etj.,	Leke/vit	10 000

Strukturat e ngarkuara per mbledhjen e **tarifave te sherbimeve** jane Drejtorite perkatese te Bashkise Kuçove .

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1. Bashkia Kuçove mund te hyje ne kontakte me subjekte te tjere shtetore ose private, per vjeljen e disa tarifave dhe taksave ne rolin e agjentit tatimor duke i lene subjektit qe do te sherbeje si agjent nje perqindje te caktuar. Per kete midis paleve do te hartohet nje akt – marreveshje e cila do te nenshkruhet nga titullaret e subjekteve perkatese.
2. Cdo Drejtori ne Bashki nuk duhet te kryeje asnje veprim ndaj qytetareve/subjekteve, te cilet nuk kane likujduar detyrimet per taksat dhe tarifate vendore ndaj Bashkise Kuçove .
3. Per te gjitha procedurat e tjera jo te permendura ne kete pakete fiskale, te ndiqen procedurat e parashikuara ne ligjet dhe udhezimet specifike per cdo takse/tarife.
4. Nga pagesa e Taksave dhe Tarifave nuk perjashtohet asnje kategori taksapaguesish me perjashtim te rasteve kur eshte parashikuar me siper si dhe rasteve te specifikuara ne ligje dhe udhezime perkatese.
5. Per subjektet e biznesit te madh e te vogel qe kane disa aktivitetet brenda nje emertimi dhe me vendndodhje te ndryshme, taksat dhe tarifate vendore do te paguhen per çdo vendndodhje.
6. Per lidhjen e kontratave me Agjentet Tatimor autorizohet Kryetari i Bashkise.
7. Kjo Pakete eshte reflektuese edhe per Vendimet, ligjet dhe udhezimet qe mund te dalin gjate vitit ne vazhdim.
8. Me ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e te Ardhurave , Drejtoria e Finances & Buxhetit , Drejtoria e Urbanistikes dhe Planifikimit te Territorit, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Drejtoria Juridike, Policia Bashkiake, Inpektoriati Ndertimor, Agjentet tatimore

Ky vendim i shtrin efektet nga data 01.01.2016 e ne vazhdim.

Vendimi Nr. 23 u miratua me - vota pro, - vota kunder dhe vota abstenim, ne prezence te 23 anetareve te Keshillit Bashkiak.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

GJERGJI MIHALI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KUÇOVE

VENDIM

NR. 05 DATE 31.01.2016

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TE VENDIMIT NR. 48 DATE 09.12.2015 TE KESHILLIT BASHKIAK “MBI MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TE VITIT 2016”

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 31/01/ 2016, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e te Ardhurave mbi miratimin e disa ndryshimeve te vendimit nr. 48 date 09.12.2015 te paketes fiskale te vitit 2016, ne zbatim te ligjit nr. 142/2015 date 17.12.2015 :

VENDOSI:

Të miratoje ndryshimet ne nivelin e disa taksave dhe tarifave për vitin 2016, si më poshtë:

1. TAKSA VENDORE BIZNESIT TE VOGEL

A Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel

Eshte : Te ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel per vitin 2016 do te realizohen ne zbatim te ligjit nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" te ndryshuar me ligjin Nr , date 2015.

Plotesohet: Me ligjin Nr.142/2015 date 17.12.2015.

2. TAKSA E PASURIVE TE PALUAJTSHME

Shtohet : "Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin."

2.1 TAKSA MBI NDERTESAT

Shtohet : "Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa."

2.2 TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

Shtohet : "Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokes bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa."

2.3 TAKSA E TRUALLIT

Eshte: Taksa e truallit do te aplikohet per here te pare sipas ligjit nr. , date 2015.

Plotesohet: Taksa e truallit do te aplikohet per here te pare sipas ligjit nr.142/2015, date 17.12.2015.

Shtohet : "Truall" është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të."

Taksa mbi truallin

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas

dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2.1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror.

Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2.1, të këtij ligji.

3. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

3. TAKSA E FJETJES NE HOTEL

- **Eshte :** Ne zbatim te ligjit nr , date 2015,
- **Plotesohet:** Ne zbatim te ligjit nr 142/2015, date 17.12.2015, neni 13;
- **Shtohet :** Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:
- a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:
- 2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel
- 3. Niveli tregues i taksës është:
 - Per hotelet me 4 – 5 yje 105 leke/nate fjetje
 - Per te tjerat 35 leke/nate fjetje
- 4 . Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.”

4. TAKSA PER ZENIEN E HAPESIRAVE PUBLIKE

Pika 7 “Taksa për zënien e hapësirave publike”, shfuqizohet. Kjo “takse” emerohet “tarife”

Në nenin 35, “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”, pika 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje: “c) paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për

administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar.

Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor”.

5. TAKSA E TABELES

Shtohet : Neni 32

Këshilli bashkiak cakton bazën dhe nivelin e taksës së tabelës.”.

Tabelë për qëllime identifikimi:

a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. 0 leke ne vit

a.1) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. 45 000 leke m2 ne vit

b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim. 120 leke m2 ne vit

6. TARIFAT E SHERBIMEVE

Shtohet :

1. Tarife per K.U.Z.

Tarifa per K.U.Z. ne Njesine administrative Kozare, eshte 600 leke ne vit per ato familje qe jane te lidhura.

2. Tarife per faturimin e ujit te pijshem ne Njesine administrative Kozare:

- Per familjaret 60 leke/m3

- Per entet shtetërore dhe bizneset 100 leke/m3

Ky vendim i shtrin efektet nga data ___/___/2016 e ne vazhdim.

Vendimi Nr. 05 u miratua me 23 vota pro, 2 vota kunder dhe - vota abstenim, ne prezence te 25 anetareve te Keshillit Bashkiak.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

GJERGJI MIHALI